

Klubi i Futbollit
“DUKAGJINI” – Klinë

**Raport i Auditorit të Pavarur
dhe Pasqyrat Financiare**

Për vitin kalendarik që përfundon
me 31 Dhjetor 2024

Prill 2025

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR*Për Bordin e KF “DUKAGJINI”***Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2024****Opinionit**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Klubit Futbollistik “DUKAGJINI” Kinë (me tutje referohet si “Klubi” apo KF), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2024, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, të cilat përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të me datën 31 Dhjetor 2024, performancën financiare dhe flukset e parasë si edhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) për NVM-të.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Klubi në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje e theksuar

KF nuk ka prezentuar shpalosjet e pozicioneve të pasqyrave financiare për vitin 2024.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të) për NVM-të., dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Klubit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Klubin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Klubit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Klubit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Klubit për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Klubit të ndërpresë veprimtarinë
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

HN Consulting SH.P.K.
Haxhi Nimanaj, auditor ligjor
Data, 02.04.2025

Klubi i Futbollit "DUKAGJINI" – Klinë
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

RAPORTI FINANCIAR VJETOR

Emri: Klubi i Futbollit "DUKAGJINI"

Numri Fiskal: 602317324 , Numri si OJQ : 5110706

Adresa: Klinë, Rr.Abedin Rexha- Ndertesa e Kuvendit Komunal

**Pasqyra e pozitës financiare
më 31 dhjetor 2024**

	Shënimi	2024	2023
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja /Keshi /banka	11	247	1,009
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		247	1,009
Pasuritë afatgjata			
Gjithsej pasuritë afatgjata		0	0
Gjithsej pasuritë		247	1,009
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		0	0
Detyrimet afatgjata			
Gjithsej detyrimet afatgjata		0	0
Gjithsej detyrimet		0	0
EKUITETI			
Fondet	18	1,009	425
Tepriat / mungesa e te hyrave	18	-762	584
Rezervat e tjera	18	0	0
Gjithsej ekuiteti		247	1,009
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		247	1,009

Drejtori i përgjithshëm

Fabion Veseli

[Signature]



Kontabilisti i çertifikuar

03-004/2021

Nr.certifikates

[Signature]
Kontabilist i Certifikuar
JETON SEJDIJA
Licenca: 03-004/2021

Klubi i Futbollit "DUKAGJINI" – Klinë
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

Pasqyra e ndryshimeve në Ekuitet
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024

Pershkrimi	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat tjera	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2023	0	0	425	425
Fitimi / (humbja) i/e vitit		584		584
Gjendja më 31 dhjetor 2023	0	584	425	1,009
Gjendja më 1 janar 2024	0	584	425	1,009
Fitimi / (humbja) i/e vitit		-762		-762
Gjendja më 31 dhjetor 2024	0	-179	425	247

Pasqyra e rrjedhjes së parasë
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024

Pershkrimi	2024	2023
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Te hyrat nga Federata -Sponsorizimet - Subvencionet - Donacionet	532,181	913,309
Aktivitet e ndryshme operative	532,943	912,725
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative	-762	584
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative		
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative	-762	584
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese	0	0
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese	0	0
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	-762	584
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	1,009	425
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	247	1,009

Klubi i Futbollit "DUKAGJINI" – Klinë

Shënimet në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

I. Informata të përgjithshme

Klubi i Futbollit "DUKAGJINI" – Klinë është organizatë joqeveritare e regjistruar në bazë të nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-043 Për Liritë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Data e regjistrimit të KF DUKAGJINI – Klinë është me 22.02.2006

Numri i Certifikates së regjistrimit është 5110760-8

Numri fiskal është 601830145

Adresa e KF DUKAGJINI – është: Klinë, Rr.Abedin Rexha- Ndertesa e Kuvendit Komunal

Themelues të klubit janë:

1. Binak Kalludra
2. Fabion Veseli
3. Valon Duraku
4. Naser Kalludra
5. Ramush Agushi
6. Isuf Berisha
7. Xhafer Berisha
8. Burim Hoti
9. Hasan Gashi
10. Alban Berisha etj. Gjithsejt 25 persona.

Organet e Organizates

1. Kuvendi
2. Bordi
3. Drejtori (Kryshefi Ekzekutiv)

Menaxhmenti

Fabion Veseli , shef ekzekutiv

Aktiviteti :

Klubi është themeluar me qellim të zhvillimit të aktiviteteve sportive , dhe kryesisht me zhvillimin e lojës së Futbollit në përgjithësi.

Klubi i Futbollit "DUKAGJINI" – Klinë

Shënimet në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

III. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Bazat e përgatitjes dhe politikat kontabël

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Raportimit Financiar ("SNRF") për NVM-të të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF të miratuara kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kritike kontabël. Ai gjithashtu kërkon që menaxhmenti të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Klubit.

Baza e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në baza historike të kostos përveç rivlerësimit të pasurisë së caktuar për asete dhe detyrime të caktuara që janë vlerësuar me vlerën reale.

Monedha funksionale dhe raportuese

Monedha funksionale e Klubit është monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin operon njësia ekonomike.

Pasqyrat Financiare janë paraqitur në njësi monetare Euro (€), e cila është edhe monedha funksionale për Klubin. Euro (€) është valuta kombetare në Kosovë.

Prona, impiantet dhe pajisjet

Momentalisht Klubi nuk ka të regjistruara prona, impiante apo pajisje tjera.

Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë të holla në bankë dhe në dorë. Për qëllime të rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë para në dorë dhe të parave të gatshme të mbajtura në bankat, duke përfshirë depozitat me afat maturimi më pak se tre muaj.

Të arkëtueshme dhe kërkesat tjera tregtare

Të arkëtueshmet tregtare janë regjistruar fillimisht me shumën e arkëtuar kundrejt shitjes së produkteve. Më pas të arkëtueshmet tregtare janë dhënë në koston nominale minus lejimi për borxhet e dyshimta.

Njohja e të Hyrave

Kryësisht të hyrat e Klubit janë nga Sponsorizuesit dhe Donacionet.

Detyrimet

Një detyrim njihet në qoftë se, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Klubit i lindin detyrime ligjore ose konstruktive të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit.

Llogarit e pagueshme

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutor janë të përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

Klubi i Futbollit "DUKAGJINI" – Klinë

Shënimet në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

Llogarit e Pagueshme njihen kur shuma është e përcaktueshme dhe obligimi për te paguar këtë shume ekziston si rezultat i veprimtarive ekonomike. Ato paraqiten sipas kostos.

Shpenzimet e periudhës

Shpenzimet janë njohur ne momentin e ndodhjes

Shpenzimet operative dhe shpenzimet tjera njihen në Pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve në datën e kryerjes së shërbimit, marrjes së përfitimit ose në datën e origjinës.

Zotimet

Më 31 dhjetor 2024, Klubi nuk ka pasur zotime.

Detyrimet kontingjente

Nuk ka raste të evidentuara të gjykatës ose depozita lidhur me Klubin, drejtorët ose punëtorët e Klubit që mund të rezultojë me detyrime në të ardhmen.

Ngjarjet pasuese

Nuk ka ngjarje pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar që kërkon korrigjime ose shpalosje në pasqyrat financiare.

Çeshtje tjera

Nuk kemi prezentuar shpalosjet e pozicioneve te pasqyrave financiare per vitin 2024.

Aprovimi i pasqyrave financiare

Pasqyra financiare janë aprovuar nga menaxhmenti dhe janë autorizuar për publikim me date 20.03.2025.